

## SHPALLJE VENDI TË LIRË PUNE.

Tabela 1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Punëtor mirëmbajtje	KDS	Bunavi, Vlorë	Sipas Kodit të Punës së RSH	po	po	21.09.2016	06.10.2016

Formulari nr. 1

<b>1. Pozicioni i punës: Punëtor mirëmbajtje</b>
<b>2. Kodi i pozicionit: K-015, B01, nr.007</b>
<b>3. Reparti/Institucioni: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Shkolla e Trupës</b>
<b>4. Vendi: Bunavi, Vlorë</b>
<b>5. Paga: paga për funksion: bruto 25650, neto 22777</b>
<b>6. Lloji i kontratës së punës: Sipas Kodit të Punës së RSH (me afat të papërcaktuar)</b>
<b>7. Data e fillimit të aplikimit: 21.09.2016</b>
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit: 06.10.2016</b>
<p><b>9. Mënyra e aplikimit: Me dosje.</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. (ose pranë strukturës ku kërkohet plotësimi i pozicionit të lirë). Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës (Shkollës së Trupës) që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Psh.</p> <p><b>Shkolla e Trupës, Bunavi</b></p> <p><b>Vlorë</b></p>
<p><b>10. Dokumentet e aplikimit:</b></p> <p>Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kërkesën;</li> <li>▪ formularin e aplikimit;</li> <li>▪ fotokopje të kartës së identitetit;</li> <li>▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në original;</li> <li>▪ fotokopje të patentës nëse ka;</li> <li>▪ dëshmi profesioni nëse ka;</li> </ul>

- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike eëë. mod.gov.al. (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

#### **11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:**

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

#### **12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:**

- a. Grada/Titulli: C1
- b. Arsimi : 9-vjeçar
- c. Kualifikimi: Administrate
- d. Trajnimi: e pa aplikueshme
- e. Eksperiencia në Punë: preferohen ish ushtarakë
- f. Gjuha e huaj: e pa aplikueshme
- g. Kërkesa të tjera specifike:
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: e pa aplikueshme

#### **13. Përshkrimi i punës:**

- a. Detyrat kryesore: Pastrim ambienti, zyre, teritor dhe gjelberim.
- b. Përgjegjësitë: Të njohë detyrat dhe përgjegjësitë e Skuadrës për Pastrimin dhe Gjelbërimin e ambjenteve të Shkollës së Trupës

#### **14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Shkolla e Trupës mbas grumbullimit të dokumentave i përcjell ato në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.
- Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.